



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Tiranë më 01.03.2019
Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8952, DATË 10.10.2002, “PËR
LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHETETASVE SHQIPTARË”,
TË NDRYSHUAR”

HYRJE

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës shqyrtoi në mbledhjen e datës 01.03.2019 në parim, nën për nen dhe në tërësi, projektligjin “*Për një shtesë në ligjin nr.8952, datë 10.10.2002, “Përletërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar*”.

Komisioni caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Pjerin Ndreu.

Për të prezantuar projektligjin në mbledhjen e komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Brendshme .

BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar është në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe është hartuar në zbatim të neneve 78 dhe 83, pika 1, të saj.

QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

Ndryshimet në projektligjin “*Për një ndryshim në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000, “Për paisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, i ndryshuar*, vijnë si domosdoshmëri për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve, të cilëve u skadon afati i vlefshmërisë së kartës ID përgjatë vitit 2019.

Pavarësisht njoftimeve të shumta, aplikimi për rinovimin e kartave ka sjellë fluks aplikimesh nga shtetasit shqiptarë pranë zyrave në të gjitha bashkitë.

Sipas të dhënave statistikore të marra nga shoqëria koncesionare “ALEAT”, sh.p.k., pothuajse 1.4 milionë shtetasve shqiptarë, ju përfundon afati i vlefshmërisë së kartës ID në vitin 2019, dhe afati kohor në dispozicion për ripajisjen me letërnjoftim të ri elektronik është mjaft i kufizuar.

Skadimi i afatit të ID-së ndodh në shumë raste edhe me skadimin e afatit të pasaportës biometrike, dhe duke qenë se letërnjoftimi elektronik shërben si dokument identiteti bazë për identifikimin e shtetasve shqiptarë, i cili u jep mundësinë për të votuar, u siguron marrjen e shërbimeve të ndryshme publike (por jo vetëm), si dhe shërben si “dokument udhëtimi” (ndër dokumentet e tjera të vlefshme të udhëtimit) drejt shteteve me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje dypalëshe për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, për të mundësuar që të gjithë shtetasve shqiptarë, të cilëve u përfundon afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronike, t’u sigurohet e drejta kushtetuese e votës si dhe marrja e një numri të madh shërbimesh që kushtëzohen nga ky dokument zyrtar, me anë të këtij ndryshimi propozohet që afati i vlefshmërisë së letërnjoftimeve, që janë lëshuar nga data 9.2.2009 deri në datën 31.12.2009 dhe që përfundon brenda vitit 2019, të zgjatet deri në datën 31 dhjetor 2019.

PËRFUNDIM

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

- ***Në aspektin ligjor***, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- ***Në aspektin procedural***, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

RELATOR

Sadi VORPSI

KRYETARE

Ermonela (FELAJ) VALIKAJ